



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES**

**I.Numër:016-01-129258, datë: 28 Dhjetor 2022.**

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2.pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.Qershor 2008), të nenit 90, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.22, datë: 19. Tetor 2011), të nenit 12, paragrafi 1.6 i Rregullores (QRK) - Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmëve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenit 20.paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër: 01-016/01-413431, datë: 30.Shtator 2020, ne propozim te kryetarit te Komunes, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28. Dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

**Nr.85/ 2022**

**mbi miratimin e Raportit per vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga vershimet ne periudhen 20, 21 dhe 22. Nëntor 2022 në Komunën e Pejës**

1. MIRATOHET Raporti mbi vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga vershimet në Komunën e Pejës, në periudhen 20,21 dhe 22. Nëntor 2022.
2. Raporti i Vlerësimit të dëmëve të shkaktuara nga vershimet e dt. 20,21 dhe 22. Nëntor 2022 është punuar nga Komisioni Lokal për Vlersimin e Dëmëve shkaktuara në të mira materiale dhe nga ndikimi i fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Pejës me Vendim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nr. 112/02-121892/2022. dt. 23.11.2022.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti mbi Vlerësimin të dëmëve të shkaktuara nga vershimet me dt.20,21 dhe 22. Nëntor 2022.
4. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Rexhep Kurtbogaj**



**Vendimi ti dërgohet:**

1x1. MAPL.

1x1. Kryetarit të Komunës.

1x1. Komisionit Qendror për Vlersimin e Dëmëve të shkaktuara në të mira materiale dhe nga ndikimi i fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.

1x1. MPB – AME.

1x1. DMSH.

1x1. Arkivë.



## **Raport Pune i Vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës; 20.21.22/11/2022.**

Pas reshjeve intensive te shiut të datës; 20.21.22/11/2022 territori i komunës Pejës është vërshuar nga uji në shumë pjesë të territorit të saj.

Shërbimet emergjente dhe instancat kryesore vendim- marrëse duke filluar nga kryetari i komunës z Gazmend Muhaxheri, kanë ndërmarrë veprimet e duhura për tu ballafaquar më sukses ndaj situatës së rëndë emergjente të krijuar nga vërshimet.

Më gjithë përpjekjet e duhura nga subjektet relevante të angazhuara për zvogëlimin e rrezikut dhe përshkallëzimit të tij më të madh, dëmet kanë qenë të konsiderueshme.

Konform kësaj gjendje të krijuar, kryetari i komunës ka themeluar komisionin prej 5 anëtarëve për vlerësimin e dëmeve në harmoni më rregulloret dhe udhëzimet aktuale në fuqi.

Komisioni i formuar më datën; 23/11/2022, Nr, pro- 112-/02-121892/2022, ka këtë përbërje;

1. Azem Haxhiaj Kryesus i komisionit, ( Inspektor për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera).
2. Idriz Selmanaj Anëtar ( Zyrtar për hapësirat Publike).
3. Mehdi Mulaj Anëtar ( Zyrtar i lart profesional për zhvillim rural).
4. Shemsedin Abazi Anëtar ( Bashkëpunëtor profesional për rrugë lokale të pa kategorizuara dhe koordinator për ndërmarrje publike).
5. Emin Sadiku Anëtar ( Zyrtar për infrastrukturë komunale)

Gjithashtu është përcaktuar edhe sekretari i komisionit nga Drejtoria Komunale e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z Gani Krasniqi, (udhëheqës i sektorit për kërkim dhe shpëtim).

Komisioni i lart përmendur konform detyrave dhe përgjegjësive të tija, ka filluar punën, dhe është kujdesur për zbatimin e dispozitave të rregullores si dhe ka përcaktuar oraret dhe afatet kohore për realizimin e detyrave për te përfunduar më sukses vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës;20.21.22/11/2022 dhe një kositsh ka realizuar takime pune dhe vizitat në teren për vlerësimin e dëmit.

Kërkesat e parashtruara nga qytetaret janë vizituar dhe është ber vlerësimi i dëmeve.

Numri i kërkesave të parashtruara nga qytetaret për ekonomitë e tyre familjare të dëmtuara nga vërshimet e datës së lartë-cekur është 25 kërkesa.

Për veç dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare, dëme ka pësuar edhe infrastruktura komunale,

- Hapësirat publike
- Rrugë
- Rrugica
- Kanalet; ( hidrografia e ujërave, pendët dhe kanalet e ndërtuara për ujitje të tokës )
- Muret mbrojtëse të lumit të bardhë
- Tokat bujqësore dhe kulturat bujqësore.
- Si dhe rrëshqitje të dheut në prona publike dhe private.

Komisioni për se cilin rast veç e veç ka bërë vlerësimin e dëmit në bazë të dokumentacionit të ofruar nga parashtruesit e kërkesës si dhe verifikimit të gjendjes në teren nga komisioni vlerësues.

Dëmet e vlerësuara nga komisioni janë të prezantuara edhe në formë tabelore;

**Tabelori i dëmeve në ekonomin familjare**

Nr	Emri dhe mbiemri	NR,Protokolit	Adresa	Vlera e dëmit
1	Avdi Halilaj	11-325/04-121959	Stankaj	800€
2	Gëzim Shala	11-325/04-123960	Dubovë e Madhe	3900€
3	Valon Musaj	11-325/04-121077	Asllan Qeshmja	2000€
4	Arbër Gashi	11-325/04-122309	Rr UçK- Nr,60	700€
5	Edmond Gjurkaj	11-325/04-121867	Kapeshnicë ,rr Lidhja e Prizrenit	500€
6	Ferat Muslijaj	11-325/04-121674	Vitomericë	1000€
7	GJylfidane Xhemajli	11-325/04-121107	Rr Zhujë Selmani	500€
8	Albatrit SHabani	11-325/04-122073	Rr, Enver Hadri	2500€
9	Miftar Mujaj	11-325/04-124523	Jabllanicë e Vogel	2100€
10	Nijazi Qerkinaj	11-325/04-120943	Rr Lekë Dugagjini	800€
11	Sadri Qerkinaj	11-325/04-120948	RR, Lekë Dugagjini	400€
12	Arianit Luta	11-325/04-121379	Rr, Lekë Dugagjini	2000€
13	Afrim Broqi	11-325/04-122307	Rr Hasan Prishtina	1000€
14	Bajram Muriq	11-325/04-120945	Rr Lekë Dugagjini	1300€

15	Bedri Zekaj	11-325/04-121595	Jabllanicë e Madhe	1300€
16	Avdyl Halilaj	11-325/04-120630	7 shtatori	700€
17	Elton XHemajli	11-325/04-123517	Rr Enver Hadri	1500€
18	Denis Cocaj	11-325/04-122848	Qendra Pejë	2000€
19	Haki SHala	11-325/04-1225	Drelaj	26.700€
20	Bujar Kelmendi	11-325/04-123856	Rr Luigj Gurakuqi-Zatra	6000€
21	Shaban Nikqi	11-325/04-122025	Vitomericë, Rr Zek Berdynaj	4000€
22	Besar Hysenaj	11-325/04-122235	Shkrel- Rugovë	1500€
23	Muqaj Lokaj	11-325/04-124873	Fsh, Radac	250€
24	Alija Kelmendi	11-325/04-124733	7 Shtatori	900€
25	Nikoll Marku	11-325/04-124734	Fsh, Gllaviqicë	400€
TOTALI				64.750.00 €

### Tabelori i Dëmeve në infrastrukturën komunale

Nr,	Emertimi i Dëmit	Adresa	Vlera e dëmit
1	Penda e Ujitjes	Fshati; Kliqinë	180.000.00€
2	Penda e Ujitjes	Fshati Gllaviqicë	168.000.00€
3	Kanali për ujitje	Fsh, LLozhan	5000€
4	Kanali për ujitje	Fsh, Ruhot	5000€
5	Kanali për ujitje	Fsh, Buqan	5000€
6	Kanali për ujitje	Fsh, Zahaq	7500€
7	Dëmtimet e argjaturave ne pendat e ujitjes në fshatrat;	Zahaq, Vragoc, Dardania 3, Gllaviqicë, Ruhot	30.000.00€
TOTALI			400.500.00 €

**Tabelori i Dëmeve në Infrastrukturë , Rrugica të pa kategorizuara dhe trotuare**

Nr.	Emërtimi i Dëmit	Adresa	Vlera e dëmit
1	Mur mbrojtës i kanalit	Fsh, Jabllanicë e Madhe	2000€
2	Shëtitorja në 2 anët e Lumit të Bardhë	Të; Restorant Blini	9500€
3	Rruga	Fsh, Graboc. LLozhan	8900€
4	Rruga	Fsh; Glllogjan dhe Jabllanicë	2500€
5	Rruga	Fsh, Lutogllavë	1000€
6	Rruga	Fsh; Terstenik	600€
7	Rruga	Fsh; Radac dhe Jabllanicë e Madhe	1100€
8	Rruga	7 shtatori, restorant maestro	850€
9	Rruga	Qokolica	1800€
10	Rruga	Zatra, te restorant Ranch	800€
	<b>TOTALI</b>		<b>29.050.00 €</b>

**Tabelori i dëmeve nga Bujqësia**

Nr	Emri dhe mbiemri	NR,Protokolit	Adresa	Vlera e dëmit
1	Nikoll Marku	11-32501-123340	Gllaviqic	2160
2	Shaban LLuka	122354	Trestenik	4250
3	Valon Gashi	122265	LLugaxhi	5506
4	Rasim Podrimqaku	125213	Novosell	2625
5	Elbasan Hyseni	123396	Ramun	7047
6	Shefqet Dreshaj	121252	Nabergjan	5262
7	Bujar Kelmendi	128325	Dardania III	19400
	<b>TOTALI</b>			<b>46.250€</b>

**PËRMBLEDHJA E TOTALIT**

1	Tabelori i dëmeve në ekonomitë familjare	64.750.00€
2	Tabelori i Dëmeve në infrastrukturën komunale	400.500.00 €
3	Tabelori i Dëmeve në Infrastrukturë , Rrugica të pa kategorizuara dhe trotuare	29.050.00 €
4	Tabelori i dëmeve në kulturat bujqësore.	46.250 €
	<b>TOTALI</b>	<b>540.550.00 €</b>

Dëmet e shkaktuara në sipërfaqen e kulturave bujqësore i kemi trajtuar ne si komision, por vlerësimi real i dëmit do të bëhet në periudhat kohore deri në stinën e pranverës, pasi që nuk e dimë saksish shkallën e dëmit të shkaktuar nga vërshimi i ujit në këto sipërfaqe të mbjella më kulturat bujqësore ( gruri).

Mendojmë se si përfundim, ne si komision vlerësues, mund të themi se komuna e Pejës po të mos kishte ndërmarr masa reaguese, sikur që i ka ndërmarrë ku instancat vendimmarrëse dhe subjektet reaguese kanë kryer intervenime të suksesshme dhe prandaj dëmet janë zvogëluar dukshëm dhe se ne të kundërtën dëmet do të ishin dyfishuar, trefishuar, etj.

Të gjitha dëmet e prezantuara sipas kërkesave të parashtruara pranë administratës komunale të Pejës, konkretisht në DKMSH janë të protokolluara dhe të evidentuara pas datës; 20.21.22.23.... /11/2022, si dhe janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të themeluar nga kryetari i komunës z Gazmend Muhaxheri.

Konfirmimin mbi raportin përfundimtar vlerësues të dëmit të shkaktuar për periudhën e lartë- cekur, komisioni në përbërje të poshtë shënuar e ka realizuar në mënyrën më të saktë të mundshme gjë që mund të shihet në dokumentacionet e bashkangjitura raportit për se cilin rast veç e veç.

Komisioni;

1. Azem Haxhijaj- Kryesuesi i komisionit – Ing. I dip. i Teknologjisë

2. Idriz Selmanaj- Anëtar i komisionit- ing.i Hidros.

3. Mehdi Mulaj- Anëtar i komisionit- ing i dip Bujqësisë,

4. SHemsedin Abazi- Anëtarë i komisionit- ing i Ndërtimtarisë

5. Emin Sadiku- Anëtarë i komisionit- ing i Ndërtimtarisë,

mr, Gani Krasniqi  
Sekretar i komisionit